

**A K T – T H E M E L I M I**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**SKM Consulting Sh.p.k**

Sot më datën 04/01/2024 në orën 13:00 e nenshkuara Znj. Majlinda Llato, shtetase shqiptare, e bija e Xhelal dhe Kajace, lindur në Mat më 04.05.1978 e banuese në Tirane, Rruga 3 Deshmoret Ysberisht Pallati 48 Ap 26, mbajtëse e kartes se identitetit H85504086D, ne titullin e ortakut i vetem themelon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar duke u mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Kodin Civil, në ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” si dhe në ligjet e dispozitat e tjera në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

**NENI 1**

Emërtimi

Shoqëria, e cila më poshtë në këtë akt do të quhet shkurtimisht “shoqëria”, do të marrë emërtimin **SKM Consulting Sh.p.k.** dhe është person juridik i të drejtës shqiptare.

**NENI 2**

Objekti i shoqërisë

Shoqëria ka për objekt:

\* Ofrimin e shërbimeve në fushën e Financiare, ligjore, marketingut si dhe të çdo aktiviteti mbështetës apo ndihmës të kërkuar nga klientët apo nga tregu;

\* Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj kryerjen e transaksioneve me tituj dhe vecanerisht blerjen dhe shitjen e titujve me porosi të klientit dhe veprimtarinë e keshillimit të veprimtarisë me tituj. Gjithashtu shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër plotësues dhe ndihmes që ka si qëllim ofrimin e cdo shërbimi tjetër dhe kryerjen e cdo aktiviteti tjetër, në rast se rezultojnë të dobishme dhe/ose të nevojshme për përmbushjen e objektit kryesor. Shoqëria mund të marrë pjesë në mënyrë të drejtperdrejte ose terthorte në cdo shoqëri që ka objekt të ngjashëm apo që lidhet me objektin e shoqërisë. Për këtë qëllim, shoqëria mund të bashkëpunojë me, ose në cdo mënyrë tjetër, të drejtperdrejte ose terthorte, të marrë pjesë në shoqëri të tjera që kanë objekt të ngjashëm ose që kanë lidhje me objektin e shoqërisë ose ndihmes për realizimin e objektit të shoqërisë.

\* Planifikimin dhe zbatimin në emër dhe për llogari të saj si dhe të palëve të treta, të kërkimeve dhe përpunimeve statistikore të çdo lloji, të kërkimit dhe studimit të tregut nëpërmjet intervistave apo mënyrave të tjera, duke përfshirë edhe të dhënat e njohura deri tani, e që do të kryhen edhe duke përdorur teknika të bazuara mbi teknologji dhe instrumente informatike dhe telematike;

\* Administrim dhe nënkontraktim (*outsourcing*), për llogari të klientëve të vet, të veprimtarive administrative e tregtare dhe të marëdhënive me klientelën, e që do të kryhen edhe duke përdorur teknika të bazuara mbi teknologji dhe instrumente informatike dhe telematike;

\* Rimarrje e mbledhje kreditesh që do të kryhen edhe duke përdorur teknika të bazuara mbi teknologji dhe instrumente informatike dhe telematike;

\* Kryerje punimesh informatike “me çelsa në dorë”; planifikim dhe zbatim punimesh software të përshtatura dhe me porosi; ndihmë dhe shërbim mirëmbajtjeje për hardware dhe software;

\* Organizim takimesh e mbledhjes, seminaresh dhe kongresesh;

\* Kurse përgatitjeje profesionale.

Të gjitha shërbimet e lartpërmendura mund të zhvillohen si në tregun e brendshëm, ashtu dhe në tregun e jashtëm.

Shoqëria mund të angazhohet gjithashtu në çfarëdo lloj aktiviteti tjetër që nuk ndalohej me ligj.

#### NENI 3

##### Selia

Shoqëria do të ketë selinë në Tiranë, Rruga 3 Deshmoret Ysberisht Pallati 48 Ap 26, por me vendim të ortakëve mund të hapë degë, agjenci dhe zyra përfaqësimi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë tij.

#### NENI 4

##### Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar.

#### NENI 5

##### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100. (njëqind) lekë dhe është i ndarë në 1 (një) kuote me vlerë nominale 100 (njëqind) lekë. Ky kapital themeltar është i nënshkruar dhe i derdhur tërësisht me para.

#### NENI 6

##### Administrimi

Shoqëria, do të administrohet nga Znj **Majlinda Llato** i cili ka të drejta për të vepruar në marrëdhënie me të tjerë në emër të shoqërisë, në përjashtim të kompetencave që ligji ju jep shprehimisht ortakëve.

#### NENI 7

##### Viti financiar

Viti financiar i veprimtarisë ekonomike (duke përfshirë edhe këtë vit) mbyllet më 31 dhjetor të çdo viti.

#### NENI 8

Për çdo gjë që nuk është parashikuar në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat që përmbahen në Statutin e shoqërisë, Ligjet në fuqi si dhe në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij akti themelimi, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet shoqërisë dhe të tretëve, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata shqiptare.

Ky Akt Themelimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **SKM Consulting** sh.p.k. hartohet në 3 (kopje) kopje të njëjta në gjuhën shqipe, pasi lexohet me miratohet dhe u nënshkrua nga ortaku.

#### **Ortakët themelues:**

SKM Consulting sh.p.k

Majlinda Llato

